



Përmbledhje e konferencës: **„Arsimi i lartë dhe hulumtimet akademike në Kosovë – *Qou Vadis?*”**

Pasqyrë e diskutimit:

Më 14 tetor 2022, Centre for Political Courage (CPC) – pjesë e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU) – mbajti tryezë të diskutimit me temë „Arsimi i lartë dhe hulumtimet akademike në Kosovë - Qou Vadis?”. Pjesëmarrës të një debati të gjerë e të frytshëm në tryezë ishin përfaqësues të Universitetit të Prishtinës (UP), profesorë, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe si i ftuar special Prof. Joseph Marko nga Universiteti i Gracit. Konferenca u pasua me një sërë pyetjesh dhe diskutimesh ku pjesëmarrësit patën mundësinë t'i ndajnë mendimet dhe rekomandimet e tyre. Gjatë diskutimit u shfaqën katër tema kryesore. Tema e parë lidhej me gjendjen e kërkimit dhe arsimit të lartë në UP. Tema e dytë ishte prezantimi i një artikulli shkencor mbi lidhjet historike ndërmjet arsimit të lartë dhe politikës në Kosovë gjatë viteve '60, '70 dhe '80. Tema e tretë shqyrtoi gjetjet kryesore nga kërkimet dhe analizat e CPC-së në lidhje me monitorimin e arsimit të lartë ndër vite. Dhe tema e katërt trajtoi gjendjen e arsimit të lartë dhe rolin e kërkimeve në Evropë dhe më gjerë duke shtruar pyetjen se çfarë do të mund të mësonte Kosova nga këto raste.

Tema I

Tema e parë e diskutimit ishte gjendja e hulumtimit në Kosovë, më saktësisht gjendja e hulumtimit në UP. Në diskutim u theksua se që kur Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) ka filluar të aplikojë kritere më të rrepta, numri i programeve të doktoraturës në UP së fundmi është zvogëluar. Prandaj, disa programe edhe nuk kanë mundur të akreditohen nga AKA. Fatkeqësisht, nuk bëhen shumë kërkime sistematike shkencore. Zakonisht aktivitetet shkencore në UP përkrijnë e janë të lidhura ngushtë me formalitetet e promovimit akademik.

Sot, UP ka një rregullore për studimet e doktoraturës, e cila përcakton kriteret në bazë të të cilave doktorantët duhet t'i publikojnë artikujt e tyre akademikë. Bazuar në këtë rregullore të vitit 2020, të gjithë studentëve të doktoraturës u kërkohet të kenë punime të indeksuara në platformat Web of Science ose Scopus. Rregullorja parashikon më tej nivelin e mbështetjes që u jepet studentëve si nxitje për botimin e artikujve. Mbështetja financiare i jepet stafit akademik për dy botime çdo vit, e cila varion nga 200 - 1000 euro, në varësi të cilësisë së indeksimit për çdo botim. Mbështetje financiare i jepet edhe stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore. Në vitin 2021, UP ka mbështetur financiarisht gjithsej 156 publikime, ndërsa në vitin 2022 ka mbështetur rreth 180 aktivitete kërkimore. Megjithatë, krahas progresit të bërë deri tani, pjesëmarrësit theksuan se gjendja e aktiviteteve kërkimore mund dhe duhet të përmirësohet. Kjo mund të arrihet duke rritur nivelin e mbështetjes së dhënë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MESTI). MESTI mbështet aktivitetet kërkimore përmes granteve, por niveli i mbështetjes nuk është i kënaqshëm dhe duhet të rritet, në

mënyrë që stafi akademik të marrë pjesë në projekte ndërkombëtare dhe të krijojë më shumë bashkëpunim ndërkombëtar. Kjo do të arrihet duke rritur buxhetin e dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim, i cili për momentin është shumë i ulët, vetëm rreth në 0.01%.

Tema II

Tema e dytë e konferencës shqyrtoi rolin historik që institucionet e arsimit të lartë luajtën në emancipimin politik dhe kombëtar të shqiptarëve në Kosovë gjatë shekullit të 20-të. U argumentua se lidhja historike ndërmjet politikës dhe arsimit në Kosovë bëri që çdo grup etnik të ndërlihte sektorin e arsimit me objektivat e dominimit të vet politik. UP-ja në atë kohë shihej më shumë si një vend që frymëzon veprime politike në vend të një institucioni akademik. Prandaj, për shqiptarët, në varësi të periudhës, arsimi lidhej ose me frikën e asimilimit ose konsiderohej si mjet mobilizimi politik dhe kombëtar. Më tej u theksua se arsimi i lartë dhe ai universitar në Kosovë u (keq)përdorën veçanërisht nga politikanët, ku si rrjedhojë, nuk ishin parimet akademike, por qëllimi i ushqyerjes së bindjeve dhe ideologjive politike që duket se kanë qenë interesi kryesor i shumë palëve të përfshira në luftën për “themelimin dhe zhvillimin” e UP-së. Kjo temë u përmbyll duke theksuar se deri diku UP-ja arriti të prodhojë mjekë, inxhinierë dhe profesionistë të tjerë të kërkuar, por simbioza e politikës dhe arsimit të lartë shpeshherë nuk ishte e dobishme për gjenerata me mendim aktiv dhe kritik aq shumë të nevojshme.

Tema III

Tema e tretë shqyrtoi disa nga gjetjet kryesore nga kërkimet dhe analizat e CPC-së në lidhje me zhvillimin e politikave dhe monitorimin e arsimit të lartë ndër vite. Për shembull, në korrik 2021, UP kishte vetëm 24 disertacione doktorature në dispozicion për publikun, ndërsa në korrik 2022, UP arriti të publikojë, bëj të qasëshme, 391 disertacione doktorature. Kjo është një arritje e dukshme pasi që UP-ja më në fund po respekton politikën e transparencës të përcaktuara në rregulloren e saj për studimet e doktoratës. Megjithatë, kriteret për pranimin e studentëve në programet e doktoratës ende nuk janë të mjaftueshme, duke lënë hapësirë për vlerësim jo objektiv të aplikantëve. Në mënyrë që studentët e doktoraturës të jenë në gjendje të kryejnë kërkime shkencore legjitime, një nga rekomandimet e bëra në lidhje me studimet e doktoratës ishte përcaktimi i standardeve aktuale të kërkimit.

Një pjesë tjetër i këtij prezantimi ishte transparenca. Bazuar në monitorimin dhe hulumtimin e CPC-së, më shumë se 90% e studentëve në UP nuk janë pjesë aktive e organizatave studentore, gjë që shkaktohet ose nga mungesa e interesit dhe/ose mungesa e informacionit në lidhje me rolin e organizatave studentore në nivel universitar. Integriteti akademik ishte një tjetër temë interesante e prezantuar në këtë konferencë. Një nga gjetjet e paraqitura përcaktonte se Statuti i Universitetit të Prishtinës, Kodi i Etikës, si dhe Rregullorja për Masat dhe Procedurat Disiplinore, nuk përfshin domosdoshmërisht aspektet kyçe të praktikës së mirë kërkimore. Më tej, denoncimet e stafit akademik për botime në revista grabitçare, mashtruese, vijnë nga media dhe jo nga vetë rrethet akademike. Gjithashtu, disa nga sfidat kryesore që ndikojnë në gjendjen e kërkimit në UP janë ndër të tjera: mungesa e financave; kapacitetet e pamjaftueshme për kërkime; mungesa e qendrave kërkimore si dhe struktura jo efektive e jo efikase qeverisëse.

Tema IV

Tema përmblylëse e konferencës shqyrtoi gjendjen e hulumtimit dhe organizimin e arsimit të lartë në mbarë Evropën, e cila mund të përdoret për të nxjerrë mësimë edhe për UP-në dhe Kosovën në përgjithësi. Ndryshe nga Kosova, ku lulëzojnë institucionet private të arsimit të lartë, në Austri për shembull, numri i institucioneve të arsimit të lartë privat është mjaft i kufizuar, vetëm dy (2) institucione private të arsimit të lartë dhe rreth 21 universitete publike. Të gjitha këto universitete publike financohen nga shteti, pasi universitetet mbledhin pak ose aspak para nga studentët, duke qenë se tarifat e studentëve janë rreth 30 euro për semestër. Përfaqësimi i studentëve në nivel universitar rregullohet me ligj publik, prandaj studentët kanë një ndikim të fortë në vendimmarrje në Austri. Edhe kur bëhet fjalë për punësimin e profesorëve, studentët përbëjnë 30% të komisioneve.

Një pikë e rëndësishme diskutimi lidhej me *tre lloje universitetesh* që vazhdojnë të ekzistojnë në shekullin e 21-të në mbarë botën dhe se si çdo shtet duhet të ketë një përzierje të tyre. Njëri model i universiteteve është ai që synon të gjenerojë njohuri në të gjitha fushat. Në thelb, ky model synon të zbulojë të vërtetën dhe të gjejë qëllimin në çështjet kryesore. Për këtë model të njohur edhe si *modeli Humboldtian i arsimit të lartë*, universitetet kërkojnë pavarësi të plotë politike dhe vlera bazë e tij është liria akademike. Në Francë, megjithatë, ekziston një model i kundërt, ku me zhvillimin e *Grand Ecole*, studentët trajnohen për t'u bërë nëpunës të mirë civil për shtetin. Së fundi, modeli i tretë është modeli anglo-sakson në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, ku universitetet formohen nga *kolegje dhe shkolla të specializuara*. Për shembull, në SHBA, programet e doktoraturës shërbejnë kryesisht si një mjet që ofron trajnime të mëtejshme për profesorët e universitetit, prandaj, ekziston një numër i kufizuar i studentëve aktualë të doktoraturës në ato universitete.

Megjithatë, në Austri për shembull, shteti kishte kontroll të plotë mbi universitetet deri në vitin 2002. Para kësaj, asgjë nuk mund të bëhej pa marrë një miratim nga një punonjës i administratës publike. Në ditët e sotme shteti dhe universiteti negociojnë se cili universitet duhet të marrë më shumë fonde dhe për çfarë qëllimesh. Ndryshe nga Kosova, studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në organizatat studentore. Një sugjerim për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shkollave apo departamenteve në nivel universitar ishte kombinimi i disa departamenteve në një, kur e ku është e mundur, ose nxitja e bashkëpunimit ndërmjet fakulteteve dhe instituteve. Meqenëse mund të jetë sfiduese të motivohen punonjësit nga departamente të ndryshme për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin pa kompensim financiar, bashkimi i departamenteve të ngjashme mund të ndihmojë.

Fjalët përmblylëse

Fjalët përmblylëse u pasuan nga pyetje nga pjesëmarrësit në lidhje me veprimet vijuese të CPC-së dhe rolin e organizatave studentore, të cilat, në një farë mënyre, po i pengojnë studentët të marrin pjesë në vendimmarrje për shkak se janë shumë të ndikuar nga politika në Kosovë.